



REPUBLIKA E SHQIPËRISË



KËSHILLI QARKUT SHKODËR

Projektet Sociale – viti 2022

✚ Financim për shtëpinë familje “Facibeni”, ofruar nga Shoqata “Opera della Providenza Madonnina- Fond i kushtëzuar i Ministrisë së Shëndetësisë

Këshilli i Qarkut Shkodër për vitin 2022, bazuar në nenin 77 të Ligjit nr.139/2015, “Për vetëqeverisjen vendore”, Ligjin nr. 115/2021 “Per Buxhetin e Vitit 2022” pikat 1, 2/b të nenit 21 të Ligjit nr. 68/2017” Për financat e Vetëqeverisjes Vendore”, Udhëzimin nr. 9 date 20.03.2018” Për procedurat standarte të zbatimit të buxhetit, ka parashikuar ofrimin e shërbimeve të përkujdesit shoqëror rezidencial për persona me aftësi të kufizuara të grupmoshës 30-60 vjeç, në shtëpinë familje “Facibeni”, ofruar nga Shoqata “Opera della Providenza Madonnina della Grappa”, në programin 10430 ,Art 6060000, shpenzime korente, shumën **6,047,417 lekë.**”.

Shoqata “Opera della Providenza Madonnina della Grappa”, ushtron aktivitetin e saj prej 26 vitesh dhe strehon persona me aftësi të kufizuara të grupmoshës 30-60 vjeç.

Misioni i kësaj shoqate është përmirësimi i cilësisë së jetës dhe nxitja e integritit social të përfituesve ndërmjet ofrimit të shërbimeve të përkujdesit social rezidencial për persona me aftësi të kufizuara.

Shërbimet që ofrohen në qënder janë;

- Shërbimi rezidencial,
- Shërbimi mjekësor
- Shërbimi psiko-social,
- Aktivitete sociale ,kulturore,vizita
- Shërbimi sanitar.

✚ Përfshirja në jetën social- kulturore të moshës së tretë

Ky projekt synon që të përfshijë në jetën social kulturore subjektet e rezidencave publike të kësaj kategorie.

A1- Dita Botërore e të moshuarve 1 TETOR

A2- Fuqizimi dhe mbulimi me internet i gjithë hapësirës së godinës së shtëpisë së moshuarve

A3- Vizite tek shtëpia e të moshuarve në Tiranë, apo vizita muazeale, shkëmbim ideshë dhe bashkëjetese.

Vlera total e projektit 150,000 lek

✚ Mbështetje e Shoqatës së të Verbërve

Këshilli i Qarkut Shkodër çdo vit, sipas pikës 12 VKM nr 277 date 19.06.2023, financon Shoqatën e të Verbërve të Shqipërisë Dega Shkodër në vlerën prej **200,000 Lek.**